

TAX Alert ***Dhjetor 2011***

RRITJA E KAPITALIT MINIMAL TE KERKUAR PER SHOQËRITË AKSIONERE ME OFERTË PRIVATE

Parlamenti shqiptar me ligjin nr. 10475, datë 27/10/2011, miratoi disa amendime në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare" në lidhje me kërkesat minimale të kapitalit për shoqëritë aksionare me ofertë private.

Ky ligj rrit kapitalit minimal të shoqërive aksionare me ofertë private nga 2 Mio Lek në 3,5 Mio Lek. Të gjitha shoqëritë aksionare me ofertë private themeluar para hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi janë të detyruar për të përfunduar procedurat për regjistrimin e rritjes së kapitalit, të paktën deri në masën e përcaktuar me këtë ligj, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.

Dështimi për të zbatuar detyrimin sa më sipër, brenda periudhës tranzitore, do të bëjë shkak për shpërbërjen e shoqërisë dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sapo procedurat e likuidimit të kenë përfunduar.

Ky ligj hyn në fuqi më 7 dhjetor 2011.

NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 30.06.2006 "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT"

Ministri i Financave miratoi udhëzimin nr 24, datë 07/11/2011, për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 5, datë 30 qershor 2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", si më poshtë:

Nëse tatimpaguesi provon autoriteteve tatimore në çdo kohë gjatë periudhës tatimore që Tatim Fitimi për periudhën tatimore do të jetë dukshëm më e ulët se Tatim Fitimi paguar në periudhën e mëparshme apo periudhën e dytë paraardhëse, atëherë organet tatimore do të pranojnë zvogëlimin e parapagimeve të kësteve të tatim-fitimit për periudhën në vazhdim.

Nëse, pas dorëzimit të deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimi, detyrimi për tu paguar kalon më shumë se 10% të shumës së tatim fitimit të parapaguar, tatimpaguesi duhet të paguajë interes me normë 5% për diferencën ndërmjet detyrimit real vjetor dhe shumës së tatim-fitimit të parapaguar gjatë vitit.

NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 13/05/ 2008 "PËR TVSH"

Ministri i Financave miratoi udhëzimin nr. 25, datë 08/11/2011, për aplikimin e "mekanizmit të autofaturimit" në rast të shërbimeve të ofruara për taksapaguesit shqiptarë nga furnizuesit e huaj, si më poshtë:

- Nëse tatimpaguesi shqiptar kryen vetëm furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja, ky person nuk ka të drejtën e auto faturës së lëshuar në zbatim të këtij udhëzimi;
- Nëse shërbimi i dhënë nga një furnizues i huaj për një tatimpagues shqiptar është i përjashtuar nga TVSH në Shqipëri, skema e autofaturimit për këtë shërbim nuk është e aplikueshme;
- Nëse shërbimi i dhënë nga një furnizues i huaj për një tatimpagues shqiptar është i lidhur me pasurine e pa lujtshme, ofruesi i shërbimit të jashtë është i detyruar të emerojë një përfaqësues tatimor për TVSH-së në Shqipëri, pavarësisht nëse vlera e furnizimit të shërbimit kalon ose jo kufirin minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

This information is provided as a guide only and should not be construed as advice. Professional accounting and tax advice should be sought before acting upon any of the point raised in this information.